

**STATUTI  
I SHOQËRISË TREGTARE  
“DOYO PLUS” SH.P.K**

Sot, në Tiranë, më datë 30.08.2023 (dymijë e njëzetë e tre), Ortaku i vetëm themelues:

**Z. Fatih Yılmaz** i biri i Bayramit, lindur më datë 16.08.1985, në Fethiye/Turqi dhe banues në adresën, Kayaburnu mahallesi, Kayaburnu merkez sokak, no:11, Serik/Antalya,Turqi, shtetas Turk, identifikuar me Pasaportë me Nr. U22231327, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (në cilësinë e Ortakut të vetëm të shoqërisë).

I cili ka themeluar shoqerinë “DOYO PLUS” sh.p.k dhe ka vendosur të nënshkruaj Statutin e shoqërisë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kodin Civil, në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, dhe në ligjin Nr. 9723, datë 3.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), si dhe dispozitat tjera të legjitacionit Shqiptar në fuqi që rregullojnë mardhëni e Shoqërive tregtare, si vijon:

**KREU I**

**EMRI, FORMA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA, KOHËZGJATJA DHE  
KAPITALI THEMELTAR**

**NENI 1**

**Emri i Shoqërisë**

1.1. Emri i shoqërisë, në përputhje me kriteret ligjore të Republikës së Shqipërisë, është  
**“DOYO PLUS”** sh.p.k.

**NENI 2**

**Forma Ligjore**

2.1. Shoqëria “DOYO PLUS” (këtu e në vijim referuar si “Shoqëria”) është e themeluar dhe organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe aktiviteti i saj rregullohet nga ky Statut dhe ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

2.2. Shoqëria do të operojë në përputhje të plotë me ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë.



### NENI 3

#### Objekti i Veprimtarisë

Mbështetur në nenin 7 të ligjit 9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtar me objekt:

3. Ne fushën e turizmit shëndetësor shoqëria: do të sjellë nga vendet e tjera pacientë për të rifiutuar shëndetin, për çfarëdo arsy, për qëllime trajtimi në spitale ti ndjekë dhe të kryejë vetëm ose në bashkëpunim me spitale, qendra shëndetësore, klinika dentare, klinika shëndetësore private të gjitha procedurat e lidhura me shëndetin, nga kirurgjia plastike deri te fekondimi in vitro, nga transplantimi i flokëve tek trajtimi dentar, sektori i akomodimit, spitalet, objektet shëndetësore termale, qendrat SPA dhe qendrat e kurimit shëndetësor, në llixha, dhe qendrat e rehabilitimit që i shërbejnë turizmit shëndetësor.  
Çdo veprim tjeter finansiar e tregtar qe lidhet ne menyre te drejtoperdrejte ose terthorazi me objektin e veprimtarise dhe qe eshte ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

- 3.1. Në fushën e turizmit shoqëria do të kryejë: Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të infrastrukturës dhe/ose të pjesave perberese të saj, për shfrytëzimin njerezor me karakter pushues, argetues, edukues dhe/ose kurues, të burimeve natyrore, kulturore, mjedisore kurative, të Shqipërisë dhe më gjerë, për realizimin e hotelerisë, fshateve turistike, qendrave turistike e të tjera dhe krijimin e faciliteteve dhe aksesorëve të nevojshem, si bar bufe-restorante, qendra estetike, palestra fitnessi, njesi të shitjeve të konfeksioneve dhe prodhimeve ushqimore e industrial e të tjera të kësaj natyre; krijimin e agjencive turistike e të tjera.

- 3.2. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

### NENI 4


#### Selia

- 4.1 Selia e shoqërisë, në përbashje të aktivitetit të saj tregtar, është në adresën Rruga Memo Meto Nd. 82, H.1 Tiranë/Shqipëri.
- 4.2 Vendimi për transferimin e selisë së shoqërisë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.
- 4.3 Çelja e degëve dhe zyrave të përfaqësimit në qytete të tjera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të caktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

### NENI 5

#### Kohëzgjatja

- 5.1. Shoqëria do të ekzistojë për një periudhë të pacaktuar.



## NENI 6

### Kapitali Themeltar dhe Koutat e Shoqërisë

- 6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 5.000 (Pesë mijë) lekë.
- 6.2. Numri total i kuotave do të jetë një, me vlerë 5.000 (Pesë mijë) lekë.
- 6.3. Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë Kapitalin Themeltar në çdo moment nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, deri në kufirin minimal të parashikuar nga ligji në fuqi, të konsideruar si i nevojshëm për të realizuar qëllimin e themelimit të shoqërisë. Ortaku i vetëm do të ushtrojë kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme.
- 6.4. Shoqëria mund të emetojë kuota në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.
- 6.5. Procedura për zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit themeltar do të rregullohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme rast pas rasti.
- 6.6. Kuota mund të shitet, dhurohet ose transferohet palëve të treta nga Asambleja e Përgjithshme, duke respektuar të drejtën e preferimit.
- 6.7. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit do të rregullohen nga kontrata.
- 6.8. Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe në bazë të formaliteteve të vendosura nga Administratorët. Kalimi i kuotës i njostohet shoqërisë.
- 6.9. Asambleja e ortakëve me vendim te kualifikuar mund të mos pranoje qe administratoret/i të regjistrojnë kalimin e kuotës pranë QKB-së nëse kuota objekt i shitjes nuk ka qenë shlyer tërësisht në kapitalin e shoqërisë.
- 6.10. Nëse Asambleja nuk pranon të regjistrohet kalimi i kuotës, administratoret/i brënda një muaji pas datës në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në shoqëri, i dërgojnë blerësit njostimin për mospranimin.
- 6.11. Pjesë të kapitalit themeltar mund t'i transferohen edhe personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, me vendim të kualifikuar të ortakëve të shoqërisë (me 3/4) dhe vetëm pasi të jetë ezauruar ushtrimi i së drejtës së parablerjes nga ortakët ekzistues.
- 6.12. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

- 6.13. Në rastet kur shoqëria emeton një kuotë dhe mbajtësi i kuotës nuk likujdon kuotën sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në marrëveshjen mes tyre, shoqëria mund të anulojë kuotën e ortakut të ri.
- 6.14. Kalimi përmes trashëgimisë ose falimentit; nëse një ortak vdes bashkëzotëruesh e mbetur gjallë dhe, në rastin kur është zotëruesh i vetëm ose një bashkëzotëruesh i vetëm i mbetur gjallë, trashëgimtarët e tij janë të vetmit persona të cilët shoqëria i njeh si titullarë të kuotës të tij; Por asnjë dispozitë e këtushme nuk e çliron pasurinë e ortakut të vdekur nga përgjegjësia në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkërisht.
- 6.15. Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mundet që, pas paraqitjes së provave të kërkua nga Administratorët, të vendosë ose të bëhet zotëruesh i kuotës ose të kërkojë që si zotëruesh i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotëruesh vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos që të kërkojë që si zotëruesh i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës te ky person tjetër.
- 6.16. Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku gëzon të drejtat titullar i të cilave do të kishte qenë si zotëruesh i kuotës, me përjashtim të faktit që, përpala se të regjistrohet pranë QKB-së, ai nuk gëzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në asamblenë e shoqërisë.



## Neni 7

### Zmadhimi i Kapitalit

- 7.1. Ortakët mund të zmadhojnë kontributin e tyre në kuotat e kapitalit të Shoqërisë. Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet duke iu ofruar për nënshkrim kuota të reja ortakëve ekzistues të Shoqërisë në proporcione përqindjet e tyre në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë ose nëpërmjet zmadhimit të vlerës nominale të kuotave ekzistuese. Kontributet mund të jenë në para ose në çdo lloj forme të parashikuar nga ligji, duke përfshirë kontribute në natyrë.
- 7.2. Mënyra e zmadhimit të kapitalit (nënshkrimi i kuotave të reja apo zmadhimi i vlerës nominale) në lidhje me metodat dhe afatet e pagimit të kontributeve nga ortakët do të vendoset rast pas rasti me vendim të Asamblesë së Ortakëve të marrë me Shumicë të Cilësuar. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve mund të përfshijnë ndër të tjera dënimet dhe pasojat për një ortakë të rast të mos-pagesës së kontributit të rënë dakord në afatin dhe shumën e caktuar duke përshirë, po pa u kufizuar, (i) zvogëlimin proporcional të pjesës të ortakut në Shoqërisë, (ii) shitjen e detyruar të kuotave të ortakut në Shoqëri, (iii) interesa për pagesë të vonuar, etj.
- 7.3. Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së të kuotave të reja nga ortakë të rinj. Ortakë të rinj do të pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblesë së Ortakëve me Shumicë të Cilësuar.
- 7.4. Ortakët kanë vendosur që kur rritia e kapitalit është e nevojshme që Shoqëria të mbulojë të gjithë detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 6 ose 12 muajve në vazhdim, ortakët e pranishëm në asamble do të votojnë në favor të zmadhimit të kapitalit, edhe nëse nuk janë personalisht në gjendje të kontribuojnë në këtë zmadhim brenda një afati jo më të gjatë se 30 ditëve që prej datës së mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve që vendosi për zmadhimin e kapitalit, në të cilin rast kuota e tyre në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë pas zmadhimit do të zvogëlohet në favor të ortakëve që do të kontribuojnë. Nëse ndonjë prej ortakëve nuk e respekton marrëveshjen e këtij nenit, secili prej Ortakëve ka të drejtë t'i kërkojë Gjykatës zbatimin e detyrimit të Ortakëve që dështojnë në zbatimin e këtij neni 7.4.

## NENI 8


### Zvogëlimi i Kapitalit

- 8.1. Bazuar në vendimet e Asamblesë së Ortakëve, zvogëlimi i kapitalit mund të kryhet në përputhje me të gjitha procedurat e parashikuara nga Ligji i Shoqërive Tregtare.

**KREU II**  
**ORGANET E SHOQËRISË**  
**NENI 9**

**Asambleja e Përgjithshme**

- 9.1. Asambleja e Përgjithshme vepron në mbështetje të parashikimeve ligjore dhe dakortësimeve mes ortakëve të shoqërisë dhe është kompetente për cështjet e mëposhtme:
  - 9.1.1. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - 9.1.2. Ndryshimet e Statutit të shoqërisë;
  - 9.1.3. Zmadhimin dhe/ose Zvogëlimin e kapitalit themeltar;
  - 9.1.4. Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/Administratorëve, Likujduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të autorizuar;
  - 9.1.5. Përcaktimin e shpërblimeve për Administratorin, Likujduesit dhe Ekspertët Kontabël të autorizuar;
  - 9.1.6. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori apo administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - 9.1.7. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - 9.1.8. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit/administratorëve të shoqërisë;
  - 9.1.9. Blerjen, Bashkimin, Shkrirjen, Transformimin dhe procesin e Likuidimit të shoqërisë;
  - 9.1.10. Emetimi i kuotave;
  - 9.1.11. Përcaktimin e pagës, bonuseve si dhe kohëzgjatjen e emërit të Administratorit.
  - 9.1.12. Kërkesën drejtuar Administratorit të Shoqërisë për mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë rast pas rasti;
  - 9.1.13. Çështje të tjera në ngarkim të Asamblesë nga ligji dhe ky Statut.
  - 9.1.14. Asambleja e Përgjithshme vlerëson dhe vendos për cështjet e parashikuara në nenin 17 të ligjit për shoqëritë tregtare (ndalimi i konkurrencës) rast pas rasti.
- 9.2. Çdo kuotë garanton të drejtën e një vote në asamblenë e përgjithshme të ortakëve (“Asambleja e Përgjithshme”), të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë si dhe të drejtat e tjera të siguruara nga ky Statut, marrëveshjet midis ortakëve dhe parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.



## NENI 10

### Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

- 10.1. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori nëpërmjet njoftimit me postë, njoftimit me postë elektronike ose me çdo mënyrë tjetër që mund të përcillet informacioni, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
- 10.2. Asambleja e Ortakëve do të thirret nga Administratori i Shoqërisë të paktën një herë në vit në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjeter të përcaktuar në njoftim brenda gjashtë muajve të parë të çdo viti kalendarik për të miratuar pasqyrat financiare të Shoqërisë të vitit të mëparshëm finanziar.
- 10.3. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas mënyrës së parashikuar më sipër, vendimet e Asamblesë konsiderohen të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 10.4. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi (vetëm për atë mbledhje) nga një ortak tjeter apo nga një person i tretë. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
- 10.5. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga Administratori i shoqërisë duke përcaktuar rendin e ditës sipas nevojave dhe interesave të shoqërisë, të paktën 1 herë në vit.
- 10.6. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- 10.7. Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo disponojë në mënyrë tjeter aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 10.8. Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para të regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 10.9. Ortakët janë personalisht përgjegjës për njofimin e të gjithë të dhënavë të kontaktit përfshirë por jo vetëm adresën postare, numrin e faksit, adresën e postën elektronike, te Administratori i Shoqërisë dhe gjithashtu të njoftojë Administratorin për çdo ndryshim të njëpasnjëshëm të të dhënavë tyre të kontaktit. Njofimin e ndryshimeve në të dhënat e tyre të kontaktit do të hyjnë në fuqi ditën e pestë kur njofimi do të konsiderohet të jetë marrë në përputhje me paragrafin më poshtë.

Për shbangien e çdo dyshimi, çdo njoftim ose komunikim tjetër i nevojshëm për tu dhënë në përputhje me këtë Statut, do të jepet me shkrim në gjuhën shqipe dhe angleze duhet të dërgohet dhe/ose dorëzohet të paktën në dy prej mënyrave të mëposhtme, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Statut:

- Dorëzohet dorazi; ose
- Dërgohet me faks; ose
- Dërgohet me postë elektronike; ose
- Dërgohet me postë rekomande; ose
- Nëse njoftimit do të dërgohet me postë jashtë vendit nga i cili dërgohet, do të dërgohet me postë ajrore rekomande.

Adresa e Administratorit do të konsiderohet selia e Shoqërisë por Administratori është gjithashtu i detyruar të japë informacion të kontaktit të tij/saj personal (dhe çdo ndryshimi të mëpasshëm të tij) tek ortakët.

## NENI 11

### Kuorumi dhe Vendimarrja në Asamblenë e Përgjithshme

- 11.1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme 50 për qind plus 1, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 përqind e kuotave.
- 11.2. Për cështjet që kërkojnë shumicë të kualifikuar si ndryshimi i statutit, zmadhimi ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, asambleja vendos me tri të katërtat e ortakëve pjesëmarrës vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.
- 11.3. Vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në këtë statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.
- 11.4. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal, të mbajtura nga Administratori i shoqërisë. Prosesverbalit përmban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
- 11.5. Nëse Asambleja e Ortakëve është e mbledhur në mënyrë korrekte, por numri i kërkuar i ortakëve për të plotësuar kuorumin nuk është prezent apo nuk është i përfaqësuar, asambleja e ortakëve do të mblidhet sërisht në përputhje me parashikimet e Nenit 10 por jo më vonë se 30 ditë. Rendi i ditës i asamblesë së dytë nuk do të ndryshojë.



11.6. Ortakët njojin dhe pranojnë të drejtën për të vendosur në lidhje me Shoqërinë me shkrim. Vendimet e propozuara, së bashku me dokumentet që mbështesin vendimet do t'i dërgohen ortakëve nga Administratori në përputhje me nenin 10. Ortakët do të vendosin mbi vendimet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumentit i cili përmban tekstin e vendimeve, duke kthyer brenda kësaj periudhe një kopje originale të nënshkruar te Administratori i Shoqërisë dhe gjithashtu me postë elektronike, një kopje elektronike të saj. Ortakët që kanë kundërshtuar do tu jepet mundësia të shprehin kundërshtimin e tyre në lidhje me vendimin me shkrim, në dokumentin që përmban tekstin e vendimeve të propozuara. Vendimet me shkrim do të konsiderohen të miratuarë në qoftë se miratohen nga shumica e kërkuar dhe kuorumi. Për këtë qëllim, të gjithë ortakët mund të nënshkruajnë kopje të veçanta por të njëjtë të dokumentit që përmban tekstin e vendimeve të propozuara.

#### **NENI 12** **E drejta e votës dhe çështje të lidhura me të**

12. (Në varësi të të drejtave ose kufizimeve të lidhura me kuotat, secila kuotë e një ortaku i cili (si individ) është i pranishëm vetë ose përmes një prokure përfaqësimi ose (si shoqëri) është i pranishëm përmes përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt ose përmes një prokure përfaqësimi, ka të drejtën e një vote.  
Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme personalisht ose përmes një prokure përfaqësimi, në lidhje me kuotat që zotëron vetë, nëse nuk janë paguar tërësisht kontributet nga ana e tij në lidhje me kuotën në fjalë.  
Kundërshtimet e ngritura për plotësimin e kushteve nga ana e një votuesi i bëhen në kohë Kryetarit vendimi i të cilit është i formës së prerë.

12.1. Ortaku përjashtohet nga e drejta e votës vetëm në rastet kur asambleja voton mbi:

- Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- Dhënen ose jo të përfitimeve të reja;
- Situata të tjera të parashikuara me ligj.

12.2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesë, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### **Neni 13** **Dorëheqja e Ortakut**


13.1. Dorëheqja e ortakut rregullohet nga Neni 101 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

- 13.2. Ortaku i cili ka qëllim të heqë dorë nga Shoqëria duhet të japë njoftim me shkrim Administratorit për qëllimin e tij për të hequr dorë nga anëtarësimi në Shoqëri dhe arsyet e kësaj heqje dore.
- 13.3. Administratori menjëherë pas marrjes së njoftimit të përmendorur në paragrafin 2 të këtij Neni, do të thërrasë Asambleën e Ortakëve në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Statut dhe ligjin për shoqëritë tregtare për të vendosur nëse ortaku do të marrë pagesën e kuotave të tij për shkak të dorëheqjes së tij të vlefshme.
- 13.4. Asambleja e Ortakëve do të diskutojë arsyet e dorëheqjes të paraqitura nga ortaku dhe do të vendosë nëse këto arsyet janë të vlefshme dhe shumën si edhe mënyrën e shlyerjes së kuotave të ortakut që jep dorëheqjen. Ortaku që jep dorëheqjen mund të nisë procedurat përparrë gjykatës kompetente duke i kërkuar Shoqërisë shlyerjen e kuotave të tij për shkak të dorëheqjes së tij të rregullt në rast se Administratorit nuk mbledh Asambleën e Ortakëve ose ky i fundit nuk i njeh arsyet e ortakut për dorëheqje dhe të drejtën e shlyerjes.
- 13.5. Nëse Asambleja e Ortakëve nuk mblidhet për shkak të vullnetit ose mungesës së kuorimit ose nëse nuk miraton arsyet e dorëheqjes si të vlefshme pra duke mohuar të drejtën e shlyerjes për ortakun që jep dorëheqjen brenda një periudhe prej 60 ditësh nga data që Administratori ka marrë njoftimin e qëllimit të dorëheqjes, ortaku që jep dorëheqjen mund:
- Të ushtrojë të drejtën e dorëheqjes duke njoftuar Administratorin e Shoqërisë në selinë e tij duke dërguar një njoftim me shkrim brenda një periudhe prej 30 ditësh pas përfundimit të afatit të përmendorur në Nenin 13.5 më sipër. Në këtë rast dorëheqja do të konsiderohet e zbatueshme nga data e marrjes së këtij njoftimi me shkrim dhe Administratorit do të marrë të gjitha masat për të regjistruar këtë dorëheqje në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me ligjin;
- ose
- Të nisë procedurat pranë gjykatës kompetente në përputhje me Nenin 13.5, rast në të cilin dorëheqja do të konsiderohet e zbatueshme nga data e lëshimit të vendimit përfundimtar të gjykatës për këtë qëllim.

#### NENI 14

##### Administratori

- 14.1. Shoqëria tregtare "DOYO PLUS" Shpk do të përfaqësohet në marrëdhënie me të tretët nga administratori i saj, i cili vepron në cilësinë e përfaqësuesit ligjor, në përputhje me këtë statut dhe ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
- 14.2. Administrator i shoqërisë "DOYO PLUS" sh.p.k. emërohet **Z. Fatih Yılmaz** i biri i Bayramit, lindur më datë 16.08.1985, në Fethiye/Turqi dhe banues në adresën



Kayaburnu mahallesi, Kayaburnu merkez sokak, no:11, Serik/Antalya,Turqi, shtetas Turk, identifikuar me Pasaportë me Nr. U22231327, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për një periudhë 2 (dy) vjeçare, duke filluar nga dita e regjistrimit në QKB, me të drejtë rizgjedhje.

Të dhënat e identifikimit:

(Fazik.../Imam.)  
(Aydemir...)

14.3. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë administrator i një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

14.4. Administratori kryen detyrat e tij në përputhje me parashikimet ligjore të detyrimit të besnikërisë sipas neneve 12 (Përfaqësimi), 14 (Besnikëri ndaj shoqërisë), 15 (Informimi për ortakët e shoqërisë sipas parashikimeve ligjore), 17 (Ndalimi i Konkurrencës) e 18 (Sekreti Tregtar) të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

#### NENI 15

##### Detyrat dhe përgjegjësítë e Administratorit

15.1. Administratori i shoqërisë është përgjegjës për:

- a) Manaxhimin e veprimtarisë së biznesit me implementimin e politikave të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) Përfaqësimin e shoqërisë tregtare;
- c) Kujdesjen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) Përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin vjetor të përformancës së shoqërisë. Paraqitjen e dokumenteve në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për miratim së bashku me propozimin dhe shpërndarjen e fitimeve;
- e) Krijimin e një sistemi paralajmërues për zhvillimet që mund të cënojnë shoqërinë;
- f) Raportimin në Asamblenë e Përgjithshme mbi implementimin e politikave të të bërit biznes dhe realizimin e transaksioneve me rëndësi të vecantë për performancën e shoqërisë;
- g) të thërrasë Asamblenë e Ortakëve, kurdo që e konsideron të nevojshëm për interesat e Shoqërisë dhe të ndërmarrë të gjitha formalitetet për thirrjen e rregullt të mbledhjes

- h) Kryerjen e detyrave të parashikuara nga ligji ose Statuti.
- 15.2. Administratori mund të lidhë kontrata apo të hyjë në marrëdhënie të tjera tregtare, nëse deklaron kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interesit të tij e veprimi autorizohet paraprakisht nga të gjithë ortakët e shoqërisë. Çdo miratim paraprak dhe i përgjithshëm njoftohet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 15.3. Administratori mund të autorizojë palë të treta për kryerjen e veprimeve të ndryshme, të tilla si: depozitimin e Pasqyrave Financiare në Qendrën Kombëtare të Biznesit, përfaqësimin e shoqërisë para institacioneve shtetërore etj., përpara organeve gjyqësore, përvec rasteve të parashikuara si kompetencë ekskluzive e Administratorit nga ligji ose ky Statut.
- 15.4. Administratori i shoqërisë mund të veprojë në kundërshtim me parimin e ndalimit të konkurrencës, vetëm me autorizimin përkatës të Asamblesë së Përgjithshme, parashikuar në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Çdo veprim në kundërshtim me këtë parashikim është i pavlefshëm e për pasojë nuk sjell efekte juridike.
- 15.5. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.
- 15.6. Shpërblimi i administratorit përcaktohet me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme. Shpërblimi bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të janë në përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet do të janë në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.
- 15.7. Administratori i shoqërisë i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e tij, të parashikuara në këtë statut apo në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, me profesionalizëm dhe mënjanon në çdo rast konfliktin e interesit në procesin e administrimit të shoqërisë.
- 15.8. Në ushtrimin e detyrës së tij, administratori udhëhiqet në interes të lartë të shoqërisë edhe në rastet kur një ortak i shoqërisë kërkon ndryshe, qoftë ky ortak në shumicë apo në pakicë.

**Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësitë**

16.1 Përveç detyrimeve të përgjithshme të parimit të besnikërisë së parashikuar në Nenin 14,15,17 dhe 18 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Administratori duhet të:

- a. të kryejë detyrat e tij në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare apo këtë Statut në mirëbesim dhe duke marrë parasysh interesat e Shoqërisë si e tërë, dhe në veçanti duke konsideruar ndikimin në mjedis të veprimtarisë së saj;
  - b. të ushtrojë kompetencat e tyre të caktuara prej Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo këtij Statuti, vetëm për qëllimet e paracaktuara aty;
  - c. të konsiderojë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat duhet të vendoset;
  - d. të parandalojë dhe të shhangë konflikte potenciale ndërmjet personave të interesuar dhe Shoqërisë;
  - e. të ushtrojë detyrat e tyre sipas parimit të kujdesit dhe të profesionalizmit;
  - f. të vë në dispozicion çdo informacion në lidhje me biznesin dhe të dhëna ekonomike të Shoqërisë të kërkuar nga secili prej ortakëve, brenda një fati kohor të përshtatshëm dhe në çdo rast jo më vonë se 30 ditë. Informacioni dhe të dhënat duhen përditësuar.
- 16.2. Administratori i shoqërisë, gjatë ushtrimit të profesionit të tij, do të jetë përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi apo mosveprimi është ushtruar në mirëbesim.
- 16.3. Në rast shkeljeje të detyrave dhe të standardeve profesionale të parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Administratori ka detyrimin të dëmshpërblejë Shoqërinë për çdo dëm që rezulton nga këto shkelje. Ai gjithashtu duhet të dorëzojë çdo fitim personal të përfituar nga ai apo persona të lidhur gjatë shkeljes së detyrimeve të tij. Ai do të ketë barrën e provës për të provuar përputhshmërinë e ushtrimit të detyrave të tij me standartet e kërkua.
- 16.4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryen veprimet e mëposhtme:
- a. u kthen anëtarëve kontributet;
  - b. u paguan anëtarëve interesa apo dividendë;
  - c. u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - d. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

**KREU III**  
**EKSPERTI KONTABËL, DIVIDENDI, PRISHJA, LIKUIDIMI, TË NDRYSHME**  
**NENI 17**

**Eksperti(ët) Kontabël të Autorizuar**

- 17.1. Eksperti(ët) Kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, nëse është e nevojshme; Eksperti(ët) Kontabël të autorizuar do të kryejnë detyrat e tyre në përputhje me normat ligje në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 18**

**Dividendët dhe Fitimi**

- 18.1. Ortaku(ët) kanë të drejtë e ndarjes së fitimeve të paraqitura në pasqyrat financiare të Shoqërisë të cilat do t'i shpërndahen në raport me kuotat e tyre, në përputhje me dispozitat e Nenit 77 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 18.2. Dividendi do të shpërndahet cdo fundviti finanziar përvèc se kur Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të cilësuar për të investuar në shoqëri. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk ka marrë vendim deri më datë 31 Maj të viti pasardhës, Dividendi do t'u shpërndahet ortakëve dhe Administratori mund të shpërndajë Certifikatën e aftësisë paguese sipas nenit 77 të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

**NENI 19**

**Viti Financiar**

- 19.1. Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

**NENI 20**

**Bilanci dhe Mbajtja e Llogarisë**

- 20.1. Bilanci i Shoqërisë kontrollohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'ju paraqitur organeve tativore përpërfundimit të muajit mars të viti pasues.



20.2. Librat e llogarisë duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (Lek). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet, çdo muaj, në monedhën vendase.

## NENI 21

### Prishja e Shoqërisë

- 21.1. Shoqëria mbaron me vendim të Asamblesë së Përgjithshme; me celjen e procedurës së falimentimit; nëse nuk ka kryer veprimtari biznesi për 2 (dy) vjet dhe nuk ka njofuar më parë statusin inaktiv sipas ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”; ose me vendim gjyqësor.
- 21.2. Administratori ose çdo person i autorizuar prej tij do të depozitojë raportin e mbarimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me ligjin 9723 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

## NENI 22

### Likuidimi

- 22.1. Pas vendimit për mbarimin e shoqërisë, do të çelet procedura e likuidimit, përveç rasteve kur ka filluar një procedurë falimentimi.
- 22.2. Për kryerjen e procesit të likuidimit, Asambleja e Përgjithshme emëron 1(një) ose disa likuidues, për qëllim hartimin e raportit të aktiveve dhe detyrimeve të shoqërisë, deri në mbarim të procesit të likuidimit.
- 22.3. Procesi i likuidimit do të bëhet në përputhje me ligjin 9901 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.
- 22.4. Pas pagesës së likuiduesve, kapitali i mbetur i shoqërisë do t'i shpërndahet Ortakëve të Shoqërisë.

## NENI 23

### Të ndryshme

- 23.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.
- 23.2. Të gjitha situatat që nuk parashikohen nga ky Statut do të rregullohen nga ligji shqiptar Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

- 23.3. Të gjithë dokumentet për palët e treta, të tilla si njoftime, publikime, dhe faturime etj., do të pëfshijnë emrin e shoqërisë së bashku me shkurtimet “sh.p.k.”, selinë, emrin e administratorit ose të të autorizuarit prej tij.
- 23.4. Bazuar në ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme do të regjistrohen në Regjistrin e mbajtur për këtë qëllim.
- 23.5. Ky statut u redaktua ne 4 kopje me perm bajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare “DOYO PLUS” sh.p.k, dhe nenshkruehet ne të gjitha kopjet duke vendosur ne fund emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre origjinale.
- 23.6. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti do të jetë kompetente Gjykatat Shqiptare.

“DOYO PLUS” SHPK

*Z. Fehim Jumaz*

(në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë)

---

(nënshtimi)

Përfaqësuar nga Av. Aranit QINAMI

*A. Aranit Qinami*